



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:196825

Datë: 11.10.2021

Numri i dokumentit: 02262882

P.nr.1018/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Fatmir Krasniqi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fatime Bajraktari, në çështjen penale kundër të akuzuarit **D.Q.**, nga **Prizreni**, si dhe mbrojtësit të tij **av.M.Sh.**, nga Prizreni, për shkak të veprës penale dhune në familje nga neni 248 par.3 lidhur me par.1e 2 te KP-es, dhe vepra penale asgjësimi apo demtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 te KP-se, duke vendosur sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.1715-8/21 të datës 17.09.2021, pas mbajtjes së seancës fillestare publike të shqyrtimit gjyqësor, në prezencën e Prokurorit Themelor të Shtetit Shahadin Destani, të akuzuarit, me datë **27.09.2021**, morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

D.Q., nga i ati, dhe e ëma, e lindur, i lindur më datën, në Prizren, ku edhe tani jeton në rr.pnr, ka të kryer shkollën e mesme, i pamartuar, punëtor fasader, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ESHTE FAJTOR

1.Se nga muaji dhjetor të vitit 2019, e deri më 02.09.2021 në Prizren, i pandehuri me qëllim të cenimit të dinjitetit brenda një marrëdhënie familjare, në mënyrë të vazhdueshme i shkakton dhune psikologjike, fizike dhe seksuale të demtuara bashkeshortës së tij A.S., si viktime të ndjeshme, ku i pandehuri më dt.22.08.2021, përveç se e rrah fizikisht duke e goditur në pjesë të ndryshme të trupit, të njëjten e keqtrajton edhe seksualisht duke e detyruar të kryej marrëdhënie seksuale pa dëshirën e saj, e më pas pasi e demtuara vendos që të shkepus lidhjen bashkeshortore nga i pandehuri për shkak të dhunës së ushtruar, i pandehuri vazhdon keqtrajtimin psikologjik, duke e thirrur vazhdimisht përmes telefonit, me pas në pamundësi që të flas në telefon për shkak se e demtuara nuk ju paraqitet në telefon, i pandehuri vazhdon duke i dërguar mesazhe telefonike me përmbajtje ofenduese dhe kërcënuese, imë të cilat veprime tek e demtuara ka shkakuar shqetësim të madh emocional dhe ndjenje të frikës dhe pasigurisë,

-me këto veprime ka kryer veprën penale të dhunes ne familje nga neni 248 par.3 lidhur me par.1 e 2 të KP-së.

2.Me daten 02.09.2021 ne Prizren, i pandehuri me qellim te demtimit te pasigurise se te demtuares A.S., si rrjedhoje e mosmareveshjeve qe kishin me s veti dhe keqtrajtim fizik, psikologjik e seksual te pershkruara si ne dispozitivin nen 1 te kesaj aktakuze, i pandehuri i revoltuar nga kjo situatë me nje mjet te pershtatshem e demton kapakun e mororit, mbrojtësin e perparem, dy pasqyrat anesore dhe drita e anes se majte te vetures se tipit””, me regj., prone e te demtuares, me te cilat veprime te demtuares i shakaton dem material,

-kesedore ka kryer vepren penale asgjesimi apo demtimi i pasurise nga neni 321 par.1 te KP-se,

Andaj gjykata në kuptim të nenit të lartëshënuar dhe neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 71 e 72, dhe nenit 248 par.3 të KP-së, dhe nenit 365 të KPP-së, të akuzuarin:

GJYKON

Per vepren penale si ne dispozitivin nen 1 te aktakuzes, duke i shqiptuar denimin e me gjobe ne shumen prej **500 /peseqindë/ euro**, te cilen shume te denimit me gjobe eshte i obliguar qe te paguaje ne afte prej 15 diteve, pas plotefuqishmerise se ketije aktgjykimi, nese i akuzuari nuk e paguan denimin me gjobe eshte pas ekzekutimit te dhunshem, i njeiti denim me djobe do ti zevendsohet ne denim me burg, duke llogaritur per qdo 20 euro nje dite burgim, respektivisht 25 dite burgim, dhe

DENIMIN ME BURGIM

Ne kohezgjatje prej 1 /nje/ viti, ne te cilin denim do te llogaritet edhe koha e kaluar ne masen e paraburgimit nga dt.02.09.2021.

Per vepren penale si ne dispozitivin nen 2 te aktakuzes, duke i shqiptuar denimin e me gjobe ne shumen prej **300 /treqindë/ euro**, te cilen shume te denimit me gjobe eshte i obliguar qe te paguaje ne afte prej 15 diteve, pas plotefuqishmerise se ketije aktgjykimi,

Ne kuptim te nenit 78 par.1 e 2 nenpar.2.4 te akuzuarit i shqipton denimin unik me gjobe ne shumen prej 800/teteqind/ eurove, si dhe denimin me birgim ne kohezgjatje prej 1 viti, te cilen denim me gjobe do ta paguaje ne afat prej 15 diteve pas plotefuqishmerise se keteij aktgjykimi, ne rast te mospageses se denimit me gjobe as me ekzekutim i njeiti denim me gjobe do te zevendsohet ne denim me burgim ku per qdo 20 euro eshte nje dite burgim, respektivisht 40 dite burgim.

I akuzuari obligohet qe të paguaj shpenzimet e procedurës penale sado të bëhen ato, në bazë të llogorise se gjykatës, në emër te paushallit gjyqësor të paguaje shumen prej **30 /tridhjetë/ €**, në emër të kompenzimit për viktimat e krimit shumen prej **30 /tridhjetë/ €**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotefuqishmerise se këtij aktgjykimi nën kërcënim të akzektumit të dhunshëm.

E demtuara **A.S.**, nga Prizreni, rr., p.nr, per realizimin e kerkeses pasurore juridike, udhezohet ne kontest te rregullt civilo-juridik

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1715-8/2021 të datës 17.09.2021, kundër të akuzuarit D.Q., nga Prizreni, për shkak të veprës penale dhune ne familje nga neni 248 par.3 lidhur me par.1 e 2 të KP-së, dhe vepra penale asgjesimi apo demtimi i pasurise nga neni 321 par.1 te KP-se,

Gjykata ne shqyrtim fillestar gjyqesor ka vertetuar gjendjen e ketille faktike nga pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit, i cili vullnetarisht e ka pranuar fajesine, per shkak te se ciles gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyres zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonje prove e pa pranueshme, gjithashtu gjykata ne teresi ka verteuar se i akuzuari ka kuptuar natyren dhe pasojat e pranimit te fajit per vepren penale e cila i vihet ne bare, e qe pranimi i fajit eshte bere ne menyre vullnetare dhe pa kushtezime, duke u mbeshtetur ne fakte dhe prova materiale te cilat jane paraqitur ne aktakuze, per te cilat i akuzuari ka qene i njoftuar me te gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur ne perfundim se pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit eshte bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-se, dhe faktet qe permban aktakuza, ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e vepres penale te dhunes ne familje nga neni 248 par.3 te KP-se, dhe vepres penale asgjesimi apo demtimi i pasurise nga neni 321 par.1 te KP-se, per kete gjykata te akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi denimin me gjobe dhe burgim si te merituar, paraprakisht duke e vertetuar pergjegjesine e tije penalo-juridike.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 të KPK, të cilët ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, në rastin konkret gjykata gjeti rrethana rënduese se te i akuzuari D.Q., si kryers i vepres penale te dhunes ne familje, ekziston dashja, si element i kryerjes se vepres penale, me vepren penale te dhunes ne familje, ka per qellim qe te demtuaret – viktime e ndieshme, ti shkaktohet keqtrajtim fizik, psikologjik me qellim te cenimit te dinjitetit njejrezor e trupor brenda marredhenies familjare, jane vepra penale ne trend dhe paraqesin rrezik permanent per familjen, rrethin e shoqerine, i akuzuari eshte edhe perserites/recedivist/ i veprave penale dhe ate me aktgjykime te formes se prer ye gjykates themelore ne Prizren, P.nr.69/2008, P.nr.1176/2009, dhe P.nr.1232/2010, ne kuptim te dispozitave te nenit 70, 71, 72, te KP-se, gjykata mori per baze edhe faktin se i akuzuari ka bashkpunuar me gjykatën, bashkpunimi i tije ka qene vullnetar ne hetimin dhe ndjekjen penale, i akuzuari ka pasur sjellje korrekte para gjykates, vullnetarisht ka pranuar fajesine, pranimi eshte bere pa kurfar presioni, ne nje forme eshte i penduar per kete veper penale te kryer, i premtom gjykates se ne te ardhmen nuk do te kryeje vepra penale te karakterit penal, me te demtuaren bashkeshorten e tij nuk do ta pengoje e as nuk do ta shqetesoj me asnjehere, andaj bazuar në të gjitha këto gjykata i shqiptoi masen sanksionues, duke i vertetuar denimet si ne shqiptim të këtij aktgjykimi, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësive së tije, dhe se me këto dënime si preventive, do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen i akuzuari te mos perserit vepra penale te dhunesne familje, dhe te përmbahet nga veprimet e tilla te karakterit penal, me bindje se ky dënim është proporcional me peshën e veprës penale për të cilën i akuzuari eshte shpallur fajtor, dhe do te ndikoj te i njejt ne risocializimin e te akuzuarit dhe i njejt te permbahet dhe te mos perserit vepra penale te karakterit te dhunes ne familje.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor u muar në kuptim të nenit 453 të KPPK-së.

Vendimi për programin e kompensimit të viktimave të krimit është marrë në kuptim të nenit 39 parag.3 pika 1 të Ligjit me numër 05/L-036.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.1018/2021 të datës 27.09.2021

Sekretere Juridike
Fatime Bajraktari

Gjyqtari
Fatmir Krasniqi

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.